

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

PARTIA KONSERVATORE SHQIPTARE

Ne kemi audituar tabelën e fondeve të përfituara (më poshtë "Tabela") nga Partia Konservatore Shqiptare (më poshtë "Subjekti") prej personave fizike ose juridikë vëndas, për zgjedhjet për kuvendin 2009. Kjo Tabelë është përgatitur nga drejtimi i Subjektit në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të përcaktuara në Nr.10019, date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

Përgjegjësitë e Drejtimit për Tabelën

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të kësaj Tabele në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të përcaktuara në Ligjin Nr.10019, date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të Tabelës e cila nuk përmban keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabile; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabile të arsyeshme për rrethanat financiare.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion për Tabelën duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tone në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që Tabela nuk përmban keq-deklarime materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklaratimet në Tabelë. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të Tabelës të Subjektit në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Subjektit. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e çmuarjeve kontabile të kryera nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të Tabelës.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tone, Tabela jep një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të fondeve të përfituara nga Subjekti prej personave fizike ose juridikë vëndas për zgjedhjet për kuvendin 2009 në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të përcaktuara në Ligjin Nr.10019, date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

Bazat e kontabilitetit dhe kufizimet në përdorimin e raportit

Pa e modifikuar opinionin tone, ne tërheqim vëmendjen në faktin që Tabela është përgatitur për të përmbushur detyrimet e Subjektit me dispozitat e raportimit financiar të përcaktuara në Ligjin Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Si rrjedhim kjo Tabelë mund të mos jetë e përshtatshme për ndonjë qëllim tjetër.

H&H AUDITORS SHPK

2 Nëntor 2009



Partia Konservatore

TABELA E FONDEVE TË PËRFITUARA NGA PARTIA/KOALICIONI Partia Konservatore PREJ PERSONAVE FIZIKË OSE JURIDIKË VENDAS, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN 2009

NR	PËRSHKRIMI I DHURIMIT	VLERA NE LEK	IDENTITETI I PLOTË I DHURUESIT	NIPTI	DATA E DHURIMIT	NR. I LLOGARISË KU U DEPOZITUA DHURATA
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
SHUMA TOTALE E DHURUAR Shifrë (fjalë) lek <i>zero</i>						

Shënim: Për çdo dhuratë në sende ose shërbime, subjekti zgjedhor do të llogarisë dhe deklarojë kundërvleftën në lekë të sendeve ose shërbimeve duke u bazuar në indeksin mujor të çmimeve, të publikuar nga INSTAT. Për sendet ose shërbimet, vlerat e të cilave nuk pasqyrohet në indeksin mujor të çmimeve, subjektet zgjedhore do t'i referohen çmimit të tregut në momentin e marrjes së dhuratës.

Partia/Koalicioni/Kandidat i propozuar nga zgjedhësit Partia Konservatore
Miratuar me vendimin e KQZ-së nr.266, datë 01.06.2009



*KRYETARI
AKIMAN*